



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:284163
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847933

KPPP.nr.504/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “PRISIG” Sh.a., me NUI:810842832, me seli në Prishtinë Rr.”Eduard Lir OB-2”, Lagja Arbëria, kundër debitorëve “SCITTUS TOBACCO” sh.p.k., me NUI:810869290, me përfaqësuese E.K.M., me seli në Prishtinë Lakrishtë Rr. Tirana dhe Newco Urata Supermarket, No III Sh.p.k., me NUI: 810530007, me përfaqësues A.M., me seli në Prishtinë, Bulevardi Nena Teresë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.275/20, të datës 28.04.2020, nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Magjistralen Prishtinë- Shkup, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorëve “SCITTUS TOBACCO” sh.p.k., me NUI:810869290, dhe Newco Urata Supermarket, No III Sh.p.k., me NUI: 810530007 “Trepça” SH.A., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.275/20, i datës 28.04.2020, nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “PRISIG” Sh.a., me NUI:810842832, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.275/20 të datës 28.04.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të mbetur nga faturat shumë prej 276,163.80 €, me kamatë ligjore prej 8 %, shpenzimet e procedurës përmbartimore, si dhe nëse debitori dështon të përmbush obligimin e tij sipas pikës I më sipër, procedura të vazhdoj me shitjen e paluajtshmërisë së

hipotekuar sipas të dhënave në kontratën mbi themelimin e hipotekës Nr.I LRP.12348/2019 dhe REF:2522/2019 dhe nga shitja e saj të bëhet inkasimi i borxhit.

Debitorët, brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbarimit, me arsyetim se dokumentet në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbarimore nuk paraqet dokument përmbarimor dhe se dokumentet në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbarimore nuk janë në origjinal apo kopje të vërtetuara. Ka shtuar se Kontrata LRP.12348/2019 dhe REF:2522/2019 e lidhur me datë 20.09.2019, për një periudhë 3 vjeçare gjë që kohëzgjatja e saj është deri me 20.09.2022, andaj fillimi i procedurës përmbarimore është bërë duke mos e respektuar afatin vullnetar të përmbushjes. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet dhe urdhri për përmbarim të shfuqizohet.

Kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, duke theksuar se pretendimet e debitorëve nuk qëndrojnë dhe se kontrata e hipotekës është e regjistruar sipas aktvendimit me numër 011-994-1/1322/19, andaj dokumenti i plotëson kushtet ligjore për lejimin e përmbarimit, ndërsa sa i përket pretendimit të debitorëve që dokumenti përmbarimor është kopje dhe nuk është i vërtetuar apo origjinal nuk qëndron sepse kopja e dorëzuar është e vërtetuar tek noteri. Ka shtuar se për shkak të dështimit të debitorit për të përmbushur obligimet që ka patur ndaj Doganës së Kosovës, Dogana e Kosovës ka bërë kërkesë ndaj kreditorit për të paguar vlerën prej 276,163.80 euro sipas deklaratës së garancionit, pagesë e cila është realizuar nga kreditori me datë 31.12.2019, 08.01.2020 dhe 13.02.2020, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet, urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi dhe të detyrohet debitori t'ia paguaj shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, *Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i*

përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbarimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase në propozim për përmbarim kreditori nuk ka specifikuar dokumentin përmbarimor apo dokumentin e besueshëm, ndaj të cilit është iniciuar procedura përmbarimore, për gjykatën nuk është e qartë për faktin se në paragrafin I të dispozitivit ka kërkuar përmbushjen nga faturat duke mos përcaktuar se ndaj cilit debitor kërkon këtë përmbushje ndërsa në paragrafin II është thirrur në kontratën mbi themelimin e hipotekës LRP.12348/2019 dhe REF:2522/2019 e lidhur me datë 20.09.2019, përsëri nuk është përcaktuar ndaj cilit debitori, meqenëse në rastin konkretë propozimi është drejtuar ndaj debitorit Scittus Tobacco Sh.p.k dhe Garantuesit-Hipotekë lenësit Newco urata Supermarket, kërkesë ligjore kjo e përcaktuar me nenin 38, par.1 të LPP-së e cila qartazi përcakton se propozimi për përmbarim duhet të tregoj dokumentin përmbarimor apo të besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, për më tej në shkresat e lëndës nuk gjenden faturat, por disa urdhërpagesa të realizuara nga kreditori, e që të njëjtat nuk kanë tiparet e faturës.

Në lidhje me këtë, referuar nenit 38, par.2 të LPP-së i cili parasheh se “*Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore*”, rezulton se Përmbaruesi Privat është dashur që propozimin për përmbarim të kreditorit ta kthej në plotësim për shkak të mungesës së dokumentit përmbarimor nga neni 38, par.1 të LPP-së, dhe përcaktueshmërinë e debitorit në kërkesë, e pastaj të vlerësohet se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarimit.

Nga të lartcekurat, gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozimin për përmbarim nuk është treguar apo specifikuar dokumenti përmbarimor apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, dhe rrjedhimisht i njëjti përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, si dhe nuk është përcaktuar se cila është kërkesa ndaj debitorit dhe cila është kërkesa ndaj garantuesit, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen, ngase

gjkata, në këtë fazë të procedurës, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Mbi këtë bazë, meqenëse Përmbaruesi Privat nuk ka vepruar konform nenit 38, par.2 të LPP-së, në mbështetje të nenit 43, par. 4 të LPP-së, i cili përcakton se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*, Gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.504/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.